

## VENDIM

Në Mbledhjen e Kuvendit më datë 28.04 2016 të mbajtur në Prishtinë ,

Kuvendi i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës miratoi :

### RREGULLORE PËR ANËTARËSIM asociacionit të arkitektëve të kosovës

Ky dokument hyn në fuqi menjëherë, nga data 28 Prill 2016.



Ilir Murseli

Drejtör Ekzekutiv

Person i autorizuar

Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës



# RREGULLORE PËR ANËTARËSIM

## asociacionit të arkitektëve të kosovës



2016



*Në bazë të Statutit të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: aak), në Mbledhjene e Kuvendit të sajë të 28 prill 2016 aprovoi:*

## RREGULLORE PËR ANTARËSIM

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë rregullore rregullohen: statutet e anëtarësimit, procedurat për pranimin e anëtarëve në aak, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë, procedurat e largimit, tarifat vjetore të antarësisë dhe evidentimi i tyre.

#### Neni 2

Anëtarësimi në aak është në bazë vullnetare, për të gjithë arkitektët të cilët i plotësojnë kriteret për anëtarësim pa diskriminim race, gjinie, religjioni, kombësie, moshe dhe aftësie fizike.

#### Neni 3

Obligimet e anëtarëve janë:

- 1) që të punojnë në përmbushjen e qëllimeve dhe të detyrave të **aak**;
- 2) që të respektojnë dhe zbatojnë Statutin e **aak** dhe Kodin Etik të Arkitektit;
- 3) që të marrin pjesë dhe mbështesin aktivitetet e **aak**;
- 4) që të punojnë në përsosjen dhe edukimin e vazhdueshëm profesional.
- 5) që në mënyrë të rregullt t'i kryejnë obligimet ndaj **aak**.
- 6) që të respektojnë vendimet e organeve të aak.

### ANTARESIA

#### Neni 4

Anëtarët e **aak** mund të kenë statusin e anëtarit të:

- A. rregullt;
- B. ndërlidhur dhe
- C. nderi.

#### Neni 5

Anëtar të rregullt të **aak** mund të bëhen arkitektët të cilët gjatë studimeve profesionale kanë arritur gradën akademike me sukses prej min 300 kredive ECTS (5 vite studim) në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë, ose jashtë vendit, të cilët tregojnë integritet personal dhe respektojnë Kodin Etik, dhe janë të angazhuar gjatë gjithë kohës me profesionin e arkitekturës në Kosovë.

#### Neni 6

1. Anëtar i rregullt i merituar mund të bëhet secili anëtar i rregullt i cili me punën dhe aktivitetin e vet dallohet posacërisht në lëmenjtë në të cilat vepron shoqata. Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të merituar mund ta jep secili anëtar i rregullt i **aak**. Propozimi shqyrtohet nga Kryesia dhe Zyrja Ekzekutive dhe miratimin e bën Kuvendi i **aak** me votim.
2. Anëtari i rregullt i pensionuar konsiderohet anëtari mbi moshën 65 vjet.



Anëtar i rregullt i merituar dhe anëtari i rregullt i pensionuar me anë të vendimit të Kryesisë ose të Kuvendit mund të kanë trajtim të veçantë.

#### Neni 7

Anëtar i ndërlidhur i **aak** i ka këto kategori:

- B.1 Bachelor, mund të bëhet personi që ka arritur gradën bachelor në studimet të Arkitekturës në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit me min 180ECTS.
- B.2 Student, mund të bëhet personi që vijon studimet e arkitekturës në ndonjërin prej institucioneve universitare të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit.
- B.3 Ndërkombëtar mund të bëhet arkitekti i ndonjë vendi të botës i cili në vendin e vet ose në Kosovë është i angazhuar gjatë gjithë kohës në profesionin e arkitekturës dhe tregon dëshirë që të përfitoj njohuri dhe eksperiencë me rrjetëzim në **aak**.

#### Neni 8

1. Anëtar i nderit mund të bëhet secili person i cili me angazhimin e vetë ka kontribuar në zhvillimin e arkitekturës dhe urbanizmit.
2. Propozimin për zgjedhjen e anëtarit të nderit mund ta jep secili anëtar i rregullt i **aak**, ky propozim shqyrtohet nga Kryesia dhe Zyrja Ekzekutive, kurse miratimin me anë të votimit e bën Kuvendi i **aak**.
3. Kryesia e **aak** në takimet e radhës do ti ndajë mirënjohjet personave të cilëve i njihet statusi i “Anëtarit të Nderit”. Ky status i anëtarësisë nuk i nënshtrohet pagesës së anëtarësisë.

#### ANTARESIMI

#### Neni 9

Për anëtarësim në **aak** kandidati duhet të plotësoj dhe dërgoj formularin e aplikimit në formë elektronike ose të shtypur për anëtarësi dhe:

- 1) Për kandidatët e statusit të rregullt duhet të kenë: fletëpagesën (kopje/skanuar) e paguar për anëtarësi ,një rekomandim të shkruar ose elektronik prej njërit nga anëtarët e rregullt të **aak** që tregon se kandidatët janë dëshmuar në profesion dhe kanë respektuar Kodin Etik profesionale gjatë punës së tyre;
- 2) Për kandidatët për statusin e ndërlidhur duhet të kenë: fletëpagesën (kopje/skanuar) e paguar për antarësi një rekomandim të shkruar ose elektronik prej njërit nga anëtarët e rregullt, të merituar të **aak** ose të ndërlidhur, që tregon se kandidatët janë dëshmuar në profesion dhe kanë respektuar Kodin Etik profesional gjatë punës së tyre;

Zyrja Ekzekutive brenda 7 ditëve kalendarike merr vendim për pranimin ose refuzimin e aplikimit dhe bën lajmërimin e kandidatit me anë të postës elektronike.

#### Neni 10

1. Sekretari i **aak** është udhëheqës i Zyrës Ekzekutive, dhe aty mban regjistrin e anëtarësisë me të dhënat e anëtarëve, bën evidencën dhe përditësimin e tijë.
2. Zyrës Ekzekutive është përgjegjëse për përditësimin dhe saktësinë e të dhënave për anëtarësi.



3. Të dhënat e sakëta dhe të përditësuara duhet të arkivohen dhe ruhen në formë elektronike dhe të shtypur, më së paku në dy kopje të shtypura dhe dy vende të sigurta (backup) për formën elektronike.
4. Të gjitha vendimet, vërejtjet dhe proceset që kanë të bëjnë me anëtarësi do të arkivohen në këtë shërbim.
5. Për anëtarët e ndjerë, Zyrja Ekzekutive do të mbaj evidencë dhe lista do të ruhet si lista e anëtarëve të ndjerë dhe kodi i antarësisë së anëtarit pas vdekjes nuk i merret.

## REGJISTRI

### Neni 11

Regjistri i anëtarëve dhe formulari i aplikimit do të përmbaj :

1. emrin dhe mbiemrin e anëtarit;
2. ditëlindjen;
3. adresën e vendbanimit;
4. statusin e anëtarit;
5. të dhënat për arritje akademike (kopjet e diplomave/certifikatave);
6. licencat;
7. një fotografi sipas dëshire të dërguar nga kandidati 300x300pix;
8. kontaktet me telefon dhe elektronike;
9. pagesa e anëtarësisë;
10. dhe jo domosdo : donacionet dhe kontributet nëse ka.

## KARTELA

### Neni 12

Me anëtarësimin në shoqatë, secilit anëtar do ti jepet kartela e anëtarësisë që përmban:

- identitetin personal : emër, mbiemër dhe foto
- statusin dhe kategorinë;
- kodi i kartelës së anëtarit
- data e vlefshmërisë/skadimit të kartelës.

Kartelat e anëtarësisë për anëtarët e ri do të dorëzohen brenda afatit prej 7 ditë kalendarike nga lajmërimi i aprovimit të anëtarësimin nga ana e Zyres Ekzekutive.

## PAGESA E ANTARETISE

### Neni 13

1. Pagesa e anëtarësisë është kusht për anëtarësim dhe mbajtjen e statusit të anëtarit të **aak**.
2. Tarifa është parapagim i anëtarësisë vjetore dhe bëhet sipas Statuseve dhe Kategorive.
3. Vendimin për tarifën dhe ndërrimin e tyre i propozon Kryesia dhe aprovon Kuvendi i aak.
4. Zyrja Ekzekutive është e obliguar që deri më 15 Dhjetor të çdo viti ti dërgoj formularët e parapagimit dhe të lajmëroj anëtarësinë për fillimin e parapagesës së anëtarësisë për vitin e ri që vjen.
5. Pagesa e anëtarësisë duhet të kryehet më së voni deri më 31 janar të vitit të parapaguar(rrjedhës).
6. Më 15 Shkurt Zyrja Ekzekutive do ti dërgoj vërejtjen e parë anëtarëve që janë vonuar që të bëjnë parapagimin. Me 1 mars vërejtja e dytë. Me 31 mars vërejtja e tretë me lajmërim që

- aak ka ndërmarr hapa drejt ndërprerjes së anëtarësisë të anëtarit që mund të ndodhë po që se ai nuk e kryen obligimin mbrenda 15 ditëve kalendarike.
7. Brenda muajit Prill Kryesia merr vendim për ndërprerjen e antarësisë për antarët të cilët edhe pas vërejtjes së tretë nuk i kanë kryer obligimet, dhe Zyrja Ekzekutive bën lajmërim e vendimit me postë elektronike.
  8. Nëse anëtari nuk ka mundësi ta bëjë parapagimin vjetor, ai ka të drejtë që të bëjë ngrirjen e antarësisë. Këtë e bën me kërkesë të shkruar të drejtuar Zyrja Ekzekutive e cila do të prezentoj Kryesinë për vendim. Gjatë periudhës së ngrirjes së antarësisë, anëtarit nuk i ndërpriten të drejtat dhe obligimet ndaj shoqatës pasi që nuk i nënshtrohet parapagimit të antarësisë. Në bazë të kësaj procedure të ngrirjes së antarësisë, anëtari është i obliguar që në vitin tjetër ti kryej obligimet në mënyrë retroaktive për vitin për të cilin ka kërkuar ngrirje.
  9. Për antarët të cilët antarësohen gjatë vitit e paguajnë tarifën e plotë të parapagesës për vitin rrjedhës (aktual).
  10. Antarët që bëjnë punë vullnetare për **aak**, për një periudhë pa ndërpreje prej 3 muaj ose arrijnë të kryejnë punë për shoqatën më shumë se 80 orë pune brenda vitit, janë të liruar nga parapagesa e antarësisë për vitin që pason. Kjo nuk vlen për antarët e zgjedhur të udhëheqjes dhe nëpër organet e **aak**.
  11. Statusi C. i anëtarësisë së nderit nuk ka tarifë (tarifa është 0.0 €).

#### NDERPRERJA DHE MBARIMI I ANTAREISIS

##### Neni 14

Anëtarësia në **aak** ndërpritet me:

- a) mospagesë të anëtarësisë për një vit e më shumë;
- b) dorëheqje me kërkesë personale dhe
- c) përjashtim

##### Neni 15

Anëtarësia në **aak** mbaron me:

- a) vdekjen e anëtarit dhe
- b) shuarjen e shoqatës.
- c)

##### Neni 16

1. Çdo anëtar mund të jap dorëheqje prej antarësisë duke bërë të ditur me shkrim Zyrës Ekzekutive. Me pranimin e dorëheqjes mbaron antarësia e anëtarit, kurse Kryesia e sjell vendimin për ndërprerjen e antarësisë.
2. Kryesia nëpërmjet Zyrës Ekzekutive merr vendim për ndërprerjen e antarësisë për antarët të cilët edhe pas vërejtjes së tretë me shkrim nuk e kanë kryer pagesën e obligimit ndaj **aak**. Zyrja Ekzekutive e bën lajmërimin e vendimit me postë elektronike.
3. Antarët të cilët kanë dhënë dorëheqje apo iu është ndërpre antarësia për shkak të mospagesës së antarësisë, mund të antarësohen përsëri në **aak** me procedurë standarde të aplikimit sikurse kandidatët që për herë të parë aplikojnë.
4. Vendimin për përjashtimin e anëtarit e sjell Kryesia e **aak** kurse Zyrja Ekzekutive e vë në veprim. Vendimi për përjashtim të anëtarit merret në raste kur anëtari bën:
  - 4.1 dëme të rënda morale dhe materiale për shoqatën.
  - 4.2 dëme të rënda morale anëtarit tjetër të **aak**, dhe këtë e vërteton Këshilli Disiplinor.
  - 4.3 shkeljen e statutit dhe nuk i respekton vendimet e shoqatës.

Neni 17

Pas mbarimit të periudhës së ngrirjes ,Shërbimi për antarësi i Zyrja Ekzekutive është e obliguar ta lajmëroj anëtarin për rinisjen e obligimeve të tija sipas statusit të anëtarit.

Neni 18

Zyrja Ekzekutive **aak** obligohet që në mënyrë të shkruar me vendim të lajmërojë anëtarin të cilit i ndërpritet anëtarësia në një kohë sa më të shkurtër.

Neni 19

Kundër vendimit për përjashtimin nga anëtarësia, anëtari mund të paraqesë ankesë me shkrim të drejtuar Kryesisë dhe Kuvendit nëpërmjet Zyres Ekzekutive, brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit të vendimit për ndërprejen e antarësis.

Neni 20

Zyrja Ekzekutive obligohet që çdo 3 muaj ta informoj Kryesinë në lidhje me numrin e antarëve, procesin e antarësimit si dhe masat e ndërmarura për antarsimin e antarëve të ri.

Neni 21

Zyrja Ekzekutive ka për detyrë që të ndërmarr masa në lidhje me rritjen e numrit të antarëve të aak.

Neni 22

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kryesisë së aak. Aprovimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve e bën Kuvendi i aak.

Neni 23

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj.

Për asociacionin e arkitektëve të kosovës:



Ilir Murseli

Përfaqësues i Autorizuar

13.05.2016